



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

Nr. 979/ (Prot.)

Pukë, më 10/06 2026

Lënda: Kthim përgjigje

Drejtuar: ZNJ. ERA SHERIFAJ

Adresa: Rruga Elbasanit, Ndërtesa Park Gate, Kati 10, Apartamenti 71/73, PO BOX: 2418/1, 1010

TIRANË

Në përgjigje të kërkesës për informacion, drejtuar Bashkisë Pukë, informojmë si më poshtë:

1. Bashkia Pukë, për periudhën **janar-dhjetor 2025**, nuk ka patur **buxhet vjetor të planifikuar për rininë**.
2. Bashkia Pukë, gjatë vitit 2025 nuk ka përfituar nga projekte të financuara nga donatorë që synojnë rininë.
3. Numri total i punonjësve për vitin 2025 ka qenë 350, prej të cilëve 172 femra dhe 178 meshkuj.
4. Pranë Bashkisë Pukë për vitin 2025 janë punësuar individë të moshës 18-29 vjeç gjithsej 2, prej të cilëve 2 janë femra. Asnjë prej tyre nuk është është person me aftësi të kufizuara.
5. Numri i të rinjve (18-29) punonjës të bashkisë Pukë në vitin 2025 është 26, prej të cilëve 16 femra dhe 10 meshkuj.
6. 1 person i gjinisë femërore mban pozicion drejtues, konkretisht Sekretare e Përgjithshme e Bashkisë. 0 persona me aftësi të kufizuara.
7. Bashkia Pukë nuk ka politika rinore të zhvilluara specifikisht për grupmoshën 15-29 vjeç, kjo për arsyen e thjeshtë të mosfeksionimit të një strukture të posaçme dhe mungesës së burimeve financiare.
8. Në institucionin tonë nuk kemi struktura përgjegjëse për politikat rinore.
9. E vetmja strukturë rinore e ngritur në bashki është këshilli rinor vendor.
10. Për ngritjen e këshillit rinor vendor kemi bashkëpunuar me grupe të rinjsh dhe individë.
11. Nuk kemi plan veprim për Këshillin Vendor. Për vitin 2025 nuk është organizuar asnjë aktivitet nga KVR-ja.
12. Ne kemi nevojë për mbështetje financiare, pasi buxheti i bashkisë nuk planifikon asgjë në këtë drejtim.
13. Në KVR janë përfshirë 5 të rinj, prej të cilëve 3 femra dhe 2 meshkuj. Asnjë nuk i përket personave me aftësi të kufizuara.
14. Po, kemi patur disa iniciativa dhe veprimtari bashkëpunuese me të rinj, të cilat kanë konsistuar në sensibilizimin dhe rolin e të rinjve në vendimmarrjet lokale.

15. Pjesëmarrja e të rinjve në dëgjuesat publike, mund të themi se është e ulët, për shkak të mjeteve jo efikase që përdor institucioni në përfshirjen e të rinjve në proceset e saj.
16. Bashkia Pukë nuk ofron mbështetje për sipërmarrjen rinore.
17. Në territorin e Bashkisë Pukë operon vetëm një organizatë rinore, e cila quhet ‘Lëvizja rinore’.
18. Bashkia Pukë ofron mbështetje logjistike dhe vënie ambientesh në dispozicion për rininë.
19. Bashkia Pukë ka masa as pragramme specifike për rininë
20. Mjetet e komunikimit që përdor bashkia Pukë janë:
Website: <https://bashkiapuke.gov.al/>
Facebook: <https://www.facebook.com/profile.php?id=100094947398546>
21. Numri total i përfituesve nga skema e ndihmës ekonomike për vitin 2025 është 1009. Femra 520, meshkuj 489.
22. Numri I të rinjve (15-19 vjeç) përfitues të skemës së ndihmës ekonomike për vitin 2025 është 149 gjithsej. Femra 85, meshkuj 64.
23. Numri total i përfituesve të pagesës së aftësisë së kufizuar për vitin 2025 është 430 gjithsej, prej të cilëve femra 212 dhe meshkuj 218.
24. Numri i të rinjve (15-29 vjeç) përfitues të pagesë së aftësisë së kufizuar për vitin 2025 është 46. Femra 28, meshkuj 18.
25. Numri total i personave të cilët janë pjesë e shërbimeve të kujdesit shoqëror për vitin 2025 është 9. Femra 5, meshkuj 4.
26. Numri i të rinjve të cilët janë pjesë e shërbimeve të kujdesit shoqëror për vitin 2025 është 2. Femra 2, meshkuj 0.

Faleminderit për mirëkuptimin!

KRYETARI

Rrok DODAJ

